



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



PROCESVERBAL

Konsultim Publik për Simbolet e Komunës së Gjakovës

Komuna e Gjakovës – grupi punues për hartimin e draft statusit të Komunës së Gjakovës si dhe për zhvillimin e procedurave për ndryshimin e simboleve, sipas njoftimit të publikuar në ueb faqen zyrtare (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2023/05/Konsultim-Publik-Simbolet-e-reja-te-Gjakoves.pdf>), ka mbajtur Konsultimin Publik me qytetarët e Komunës së Gjakovës, me qëllim të prezantimit para tyre dhe marrjes së komenteve e sugjerimeve për propozimet e simboleve të reja të komunës.

Konsultimi Publik ka filluar në orën 10:00 me datë 15.06.2023 në Sallën e Madhe të Kuvendit të Komunës, në objektin e ish – Bankosit.

Në këtë takim kanë marrë pjesë anëtarët e grupit punues si dhe përfaqësuesit e mediave, ndërsa nuk ka qenë prezent asnjë qytetar interesuar.

Pas prezantimit të propozimeve të reja të simboleve të Komunës së Gjakovës, në mungesë të pyetjeve, sugjerimeve apo komenteve, Konsultimi Publik është shpallur i mbyllur.

Nita Efendia



Kryetarce e grupit punues